



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 33 datë 30.7.2020

**PËR DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIEN ME QIRA TË SIPËRFAQES 155 M2
NDËRTESE SUBJEKTIT SEZAI SHPUZA, NË STADIUMIN "LORO BORIÇI",
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8591, ME SIP.28634 M2, PASURIA
NR.7/39, FLETË INVENTARI 221, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.7.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, pika 1.2, nenin 25, nenin 54 shkronja e/1 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, në ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, ligjin nr. 8744 datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendor" i ndryshuar, ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, VKM nr.421, datë 2.6.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut Shkodër, të ndryshuar, VKM nr.408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar, VKM nr.500, datë 14.8.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, pika 5, germa "a" e VKM nr.54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, mbështetur në diskutimet dhe propozimet e bëra gjatë mbledhjes, me 26 vota pro,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien e pëlqimit për dhënie me qira të sipërfaqes në stadiumin "Loro Boriçi", ndodhur në zonën kadastrale 8591, me sip.28634 m2, me nr.pasurie 7/39, fletë inventari 221 në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas përcaktimeve më poshtë:

- Sipërfaqe prej 155 m2 ndërtesë për qëllim ushtrim aktiviteti dhe ofrim shërbimi për trajtimin ushqimor të sportistëve, subjektit Sezai Shpuza
2. Kontrata e qirasë lidhet për një afat 1 (një) vjeçar, me të drejtë rinovimi
 3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit



Denis Leska

KRYETARE

